

VENDIM
Nr. 37, datë 16.1.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E BRENDSHME TE
MINISTRIA E DREJTËSISË, TË MJEDISEVE TË OBJEKTIT NR. 867/18, ME EMËRTIM “DEPO
NR. 5”, TIRANË, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 960 M², PËR SISTEMIMIN E ARKIVAVE
TË GJYKATAVE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 413, DATË 11.7.2007 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË BRENDSHME (DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE TË
SHTETIT)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 8 dhe të neneve 10 e 12 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Drejtësisë, të objektit nr. 867/18, me emërtim “Depo nr. 5”, me sipërfaqe të përgjithshme 960 (nëntëqind e gjashtëdhjetë) m², në zonën kadastrale 2529, sipas planvendosjes dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi, për ta përdorur për sistemimin e arkivave të gjykatave.

2. Objekti i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, miratuar me vendimin nr. 413, datë 11.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit)”, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Drejtësisë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Brendshëm dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha